

[Të Reja ▾](#)[Policia e Shtetit ▾](#)[Shërbime ▾](#)[Baza ligjore](#)[Vendndodhjet e policisë](#)[Video](#)[Programi i transparencës ▾](#)[Kontakt](#)[Denonco Krimin Kibernetik](#)**Lajmet e Fundit:**

Velipojë/Shkodër – U konstatuan duke ushtruar aktivitet me muzikë pas orarit të përcaktuar për mbyllje, procedohen penalisht pronari dhe menaxheri i subjektit

**Lajmet**

27/07/2021

Kurbin – Kanosi një familje duke qëlluar me armë zjarri në ajër pranë banesës së tyre, reagimi i menjëhershëm dhe profesional i Policisë ka bërë të mundur neutralizimin dhe vënien në pranga të 23-vjeçarit

Kurbin

Kanosi një familje duke qëlluar me armë zjarri në ajër pranë banesës së tyre, reagimi i menjëhershëm dhe profesional i Policisë ka bërë të mundur neutralizimin dhe vënien në pranga të 23-vjeçarit.

Sekuestrohet arma e zjarrit automatik, me të cilën i riu ka qëlluar në ajër.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, pas një telefonate në Sallën Operative, se në fshatin Adriatik, një shtetas po qëllonte me armë zjarri, menjëherë kanë shkuar në adresën e dhënë, duke parandaluar ngjarjen e mundshme kriminale.

Punonjësit e Policisë kanë bërë të mundur neutralizimin dhe prangosjen e shtetasit D. Gj., i cili për motive të dobëta ka kanosur shtetasit P. N. dhe V. N. (bashkëshortë), banues në Adriatik, Kurbin, duke gjuajtur në ajër me armë zjarri automatik, në afërsi të banesës së tyre.

Në vijim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Kurbin u arrestua në flagrancë shtetasi D. Gj., 23 vjeç, banues në Lezhë.

U sekuestrua në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit automatik me një krehër me 24 fishekë.

Materialet do i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” dhe “Kanosja”.

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko**Komisariati Dixhital****Arkiva****Linqe**

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

[◀ Skrapar – Vihet në pranga një shtetas i shpallur në kërkim për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”](#)[Shijak – Kishte përshtatur lokalit për organizmin e lotarive të palejuara, arrestohet në flagrancë pronari i lokalit ▶](#)